



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 23.04.2013
Nr. 0204-521

PËR: Nexhmedin Arifi, Kryetar i Komunës së Vitisë
Skenderbe Hebibi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë

LËNDA: KERKESË PËR RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË Nr. 01-014/320, të pranuar me datën 17.04.2013.

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në mandatin ligjor të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Shtojcën XII të Rregullores 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit Nr. 01-014/320, Për Themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale, e Kuvendit të Komunës së Vitisë, KONSTATON se:


- Vendimi Nr. 01-014/320, Për Themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 11.1 të Ligjit Nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/ Kryetari i Komunës së Vitisë, që të ndërmarrin veprime konkrete që, Vendimi Nr. 01-014/320, Për Themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 25.04.2013

Za: Nexhmedin Arifi, Gradonačelnik Opštine Vitina
Skenderbe Hebib, Predsedavajući Skupštine Opštine Vitna

**PREDMET: ZATVE ZA PONOVO RAZMATRANJE ZAKONITOSTI ODLUKE
SKUPŠTINE OPŠTINE VITINA br. 01-014/320, primljeno dana 17.04.2013.**

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu zakonskog mandata određenim po Zakonu br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu i Dodatka XII Uredbe 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja zakonitosti Odluke Br. 01-014/320, za Osnivanje opštinskog javnog preduzeća „Skupštine Opštine Vitina, KONSTATUJE da:

- Odluka Br. 01-014/320, za osnivanje opštinskog javnog preduzeća, je u suprotnosti sa dispozicijama člana 11.1 Zakona br. 03/L-087, o Javnim Preduzećima.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu člana 82 tačka 2 Zakona o lokalnoj samoupravi *traži* od Skupštine Opštine/ Gradonačelnika Opštine Vitina, da preduzmu konkretne mere, da Odluka br. 01-014/320, za osnivanje opštinskih javnih preduzeća da se uskladi sa zakonskim dispozicijama na anazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za ponovno razmatranje akta.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik Premijera i Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktprima uprava i kancelarija
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

01-013/320

15.04.2013



Komunë e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

Ne bazë të nenit 17 pika f) nenit 40.2 pika j) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 6 të Ligjit me nr 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr 03/L 087, dhe nenit 78 pika l) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 12.04.2013, aprovon këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E NDERMARRJES PUBLIKE KOMUNALE

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, APROVON Vendimin për themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale për menaxhimin e mbeturinave në gjithë territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 2

Ndërmarrja Publike Komunale për menaxhimin e mbeturinave do të jetë Shoqëri Aksionare.

Neni 3

Me këtë vendim caktohet emri i NPK "NATYRA" në Vitë dhe Emblemasë së Ndërmarrjes Publike Komunale.

Neni 4

Me këtë vendim garantohej kriteret për themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale që janë të përcaktuara në nenin 5 të Rregullores me nr 02/2013 mbi kriteret për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Komunale.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës së Vitisë.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Shërbime Publike
2. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderha Hoxha